



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **108**

Prishtinë, më 8.4.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi, Boban Todorović, Salih Morina.

Mungoi: Daut Haradinaj .

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 2.4.2013,
3. Njoftimi nga Ministria Mimoza Kusari-Lila për projektin “Plani për zhvillimin e Brezovicës”,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.3.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2.4.2013, me vërejtjen e deputetes Znj. Sevdije Lama, ”**Projekti për Gjakovën**” zëvendësohet me “**Projekti për Shkukëzën**”.

3. Njoftimi nga Ministria Mimoza Kusari-Lila për projektin “Plani për zhvillimin e Brezovicës”

Kryetari Nait Hasani falënderoi për pjesëmarrje dhe bashkëpunim Ministren Znj. Mimoza Kusari-Lila, në lidhje me çështjen e “Planit për zhvillimin e Brezovicës”. Ky plan i cili quhet “Brezovica 2” prekë edhe në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Sharri” veqanërsihtë në zonen strikte ku është pjesa e liqenit të lartë dhe ne kërkojmë të sqarojmë se cila është çështja e kësaj, pasi që dihet se sipas Ligjit të Natyrës dhe Ligjit për Parkun Kombëtar “Sharri” Zonat Strikte nuk lejohen të preken nga askush, prandaj ne dëshirojmë të dijmë nëse ky aktivitet posedon leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit.

Çështja e dytë kemi të bëjmë me derivatet e naftës, laboratorët e cilësisë dhe dëmet në shëndetin e qytetarëve që mund të sjellë nafta në Kosovë. Pasi që ne kemi patur një takim me Instiutin e Shëndetit Publik dhe ata deklarojnë se, një nga shkaktarët e mundshëm të sëmundjeve të traktit respirator mund të jenë edhe gazrat e dëmshme që lirohen nga djegia e derivateve nga makinat.

Ministria Mimoza Kusari-Lila falënderoi kryetarin dhe deputetët e Komisionit për ftesën dhe njiherit shfaqti gatishmërinë e sajë për të bashkëpunuar edhe në të ardhmen në lidhje me çështjet të cilat janë të rëndësishme për Mjedisin, për zhvillimin e gjithëmbarsheëm të shoqërisë në Kosovë dhe projekteve ekonomike të veçanëti.

Sa i përket projektit të Brezovicës me lejon shkurtimisht të ju tregoj bazën me të cilën ka fillu realizimi i këtij projekti, ky projekt ka fillu zhvillimin në një fazë tjetër “Brezovica 2” nga vendimi i Qeverisë i vitit të kalur 22.2.2012 i cili parasheh që projekti i Brezovicës të mos zhvillohet në planin apo procesin i cili ka qenë i parapare përmes Agjencionit të Privatizimit, por, të zhvillohet si proces i zhvillimit në partneritet publiko-privat. Për të realizuar këtë plan zhvillimor, Qeveria ka themeluar Komitetin Ndërqeveritarë. Ky Komitet, përbëhet nga ministrat e ministrive përkatëse, nga kryetari i Komunës së Shtërpsës dhe nga anëtarë të tjerë të institucioneve të rëndësishme të kësaj fushe, me të drejtë të plotë të votës. Ky Komitet, aktualisht është duke punuar në promovimin e shprehjes së interesit, i cili tashmë është publik nga 31 janari i këtij viti, dhe mbetet i hapur deri më 23 prill. Në përgjithësi vizioni i projektit është që do të kemi një qendër turistike i cili është i një rëndësie kombëtare i rëndësishëm jo vetëm për Komunen e Shtërpsës por edhe për tërë ekonominë e Kosovës. Objektivat kryesore të zhvillimit janë që të ketë një ndikim maksimal ekonomik, por edhe një ndikim minimal mjedisor gjegjësisht që ndikimi në mjedis që të jetë sa më i vogël i mundshëm në kuptimin e pasojave që mund të ketë si projekt në mjedis, gjithashtu si objektiv natyrisht është edhe integrimi i komunitetit lokal dhe mundësitë për zhvillimin e sektorit privat në Kosovë. Ministri i Mjedisit është anëtar i këtij Komiteti bashkë me Ministrin e Bujqësisë dhe të dytë marrin pjesë në mënyrë që të sigurojmë konsiderata dhe zbatimin e të gjitha rregullave dhe kërkesave mjedisore, njëri që ka të bëjë me rregullat mjedisore dhe tjetri me menaxhimin e pjesës ujore gjegjësisht në kuadër të Agjencisë Pyjore, aplikimi për pëlqim mjedisor për projektin e Brezovicës do të bëhet në fazën e mëvonshme pasi që të kemi një pamje të qartë të konceptit të zhvillimit dhe master planit. Në këtë fazë në jemi duke kërkuar vetëm shprehje të interesit nga kompanitë apo konserciumet, nuk jemi duke ndërmarrë ndonjë veprimtari ndërtimore në terren, gjithashtu me duhet të theksojmë se Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis përcakton se është e nevojshme që të mirret ky vlerësim për projektet që përfshijnë ekzekutimin e punëve ndërtimore apo instalimeve gjë e cila për këtë projekt nuk është në këtë fazë d.m.th. nuk ka asnjë instalim apo punë ndërtimore e cila ka të bëjë me projektin e Brezovicës dhe pasi që të kemi finalizuar në parametrat që do të punohet projekti atëherë do të fillon procedura sipas Ligjit në fuqi në Kosovë, vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe marrja e lejeve të caktuara në kuadër të zhvillimit të mëtutjeshëm.

Liburn Aliu, thotë se është i njoftuar me projekt analizën që e kanë bërë Komisioni Evropian, e cila është bërë për Zonen A që është në kuadër të krejt këtij projekti, projekti i ka zonat e veta ndër to Zona A për të cilën zonë komisioni evropian ka kërku informat nga Ministria në lidhje me leje mjedisore apo pelqim mjedisor që do të mundë të marrin dhe kanë marr përgjigje negative përshkak se hapsira në Zonen A të këtij projekti planifikohet të ndërtohet në kuadër të Parkut Nacional dhe që është një pjesë dermuese e këtij projekti në kuadër të Zonës Strikte. Sipas Ligjit, në Zonat Strikte ndalohet qfardo lloj veprimtarie dhe arritja e projektit deri në këte nivel mendoj që përben një shkëlqje ku ligji nuk e lejon një gjë të tillë. Në këtë fazë është duke u biseduar me të interesuarit të cilët do të mundë të investonin në këte zonë pra kemi mbërri në një fazë gati pothuajse përfundimtare dhe projekti i Komisionit Evropian apo ajo analiza që është bërë, parasheh shtigje të skijimit, fshatra turistike në një zonë e cila është e mbulume tërësisht nga pyje dhe parashihet që këto shtigje të skijimit edhe këto fshatra turistike të ndërtohen në këto sipërfaqe duke i prekur, krijuar sipërfaqe të hapura gjë që është krejtësisht në kundërshtim me Ligjin e posaçërisht me Ligjin e Parkut Nacional. Për Parkut Nacional Sharrin ka një plan hapësiror i cili është ende draft por i cili rrjedh si rezultat i analizave të flores dhe faunës në komplet zonën e Sharrit dhe pikërisht kjo është zona me e pasur me biodiversitet në kuadër të Parkut Nacional, mendoj se e hapësira që e përfshin zonën A nuk do duhej të ishte pjesë fare e këtij projekti sepse në start është në kundërshtim me Ligjin. Kur flasim për vlerësimin e ndikimit në mjedis ky ndikim bëhet në fazën fillestare të projekti pra në planin ideor nëse keni pas analize se cilat do të jenë profitet se si do të ndërtohen atëherë është dashur paralel me këte që të jete edhe një analizë në vlerësim të ndikimit në mjedis të kemi një raport të kësaj dhe kjo gjë nuk ka ndodhur pritet të ndodhë me vone kjo në fakt mu me jep përshtypjen që kjo zonë duhet të jete tani me e kryer përshkak se kur ti i fton investitorët dhe ju ofron një plan këto po shihet qart se sa i përket Zonës A është marrë një vendim i prirë dhe do të ndërtohet, unë mendoj që veprimet janë në kundërshtim me Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, poashtu dua që ta përmend edhe një fakt tjetër unë kam qene në muajin janar në këte zonë dhe kam ecur në këte zonë dhe nuk ka bërë mjaft për me pas skijim sepse është një zonë deri në 1800 metra. sa i përket Zonës A që është në zëmër të Parkut Nacional këtu ju sugjeroj dhe unë i bëj kërkesë Ministrisë që të heqë dorë nga qfardo investim në Zonën A ose le ta modifikoj projektin që investimet e parapara për Zonën A të barte në zonat që nuk janë zona strikte.

Unë i bëj ftesë Ministrisë në këte rast edhe komplet Komisionit Ndërmintor që të heqin dorë nga Zona A sepse është zonë e cila nuk do të sjellë zhvillim dhe përkundrazi do ta demtojë natyrën.

Salih Morina, që është e konsejcionit ndoshta nuk mund të jep efekte pozitive në mënyrë të shpejtë kush po fole që Zonë B në një formë po privatizohet po me që kjo tani është tërëhekur dhe është variante tjetër që Brezovica të jipet me konsejcion d.m.th. a i parashihni që kjo do të shkojë në një mënyrë ma të ngadalsuar se sa ajo të ishte privatizuar, kur është fjala për Zonën B dhe tek Zona A a bini ndesh me Ligjet që janë në fuqi ku ka të bëjë pikërisht me Zonën Strikte.

Afërdita Berisha-Shaqiri, pyeti sa përqind e kësaj sipërfaqe të këtij projekti të Brezovicës është Park Nacional, sa përqind është zonë strikte? Ndërsa Ministria iu përgjigj se: 1/5 e zonës strikte është në territor.

Sevdije Lama, e përgëzon Ministren edhe këtë grupin ndërmintor për iniciativën, në vazhdimisht ankohemi që skemi zhvillim ekonomik, në anën tjetër duhet ti lejojmë ata, ta shohim dobin deri tash sa e kemi pasur nga ato pyje e krahasim me dobin që do ta ketë pasi që të jepet me konsejcion ajo pjesë.

Nijazi Idrizi, pyeti a keni zhvillu debat me banorët atje, për shkak se ata atje i kanë shfrytëzuar disa resurse për mënyrën e vetë të jetesës edhe kanë mbijetuar me shekuj nëpër ato hapësira, mua më kish interesu deri sa ata të përshatën me mënyrën e re të jetesës që po ju mundësohet tash d.m.th. sa ju keni afër atyre dhe sa do të keni mundësi që të ju ofroni atyre, që edhe ata atje të jenë përfitues nga kjo mënyrë e re e jetesës.

Kryetari Nait Hasani, citon paragrafin 2 të nenit 3 të Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, "Hartimi i raportit për VSM është i detyrueshëm për planet dhe programet nga fusha e planifikimit hapësiror dhe urbanistik, në shfrytëzimin e tokës, bujqësisë, pylltarisë, peshkatarisë,

energjetikës, industrisë, minierave, komunikacionit, menaxhimit e mbeturinave, menaxhimit e ujërave, telekomunikacionit, turizmit, ... “ sa jeni ju ne koordinim me këto kërkesa të ligjit, përndryshe duhet ditur se në zonën strikte nuk lejohet ndërhyrja ?

Ministrja Mimoza Kusari-Lila sa i përket çështjes së fillimit apo vazhdimit të projektit, pajtohem plotësisht me Kryetarin e Komisionit që në Brezovicë ka pasur probleme shumë serioze në funksionalizimin gjegjësisht në mbarëvajtjen e veprimtarisë edhe të limituar edhe në kuadër të kapaciteteve ekzistuese. Ne si Qeveri vitin e kaluar nga MTI kemi nda edhe mjete të cilat ja kemi dërgu Komunes së Shtërpçës që ti kthej në funksion skiliftat gjegjësisht teleferiket që në mënyrë të pakten aktiviteti minimal të mundësohet me teleferik dhe skijim. Ka ndodhë të them një mosmarrëveshje midis kompanisë aktuale shoqërore **INEX**-it komunës dhe kontraktorit në fakt kompania që në vazhdimësi ka bërë një mirembajtje dhe funksionalizimin e skilifteve dhe nuk kanë arritur që ti shpenzojnë mjetet e dhëna nga Qeveria. Deri në fund të vitit ku dhe është mbyllur viti kalendarik dhe pastaj ato janë shkuar në suficit, kjo ka qenë skenari i vitit 2012. Ndërsa në vitin 2013 kemi bërë prap një përpjekje tjetër në gjetjen e kohës së lirë të kompanisë, gjegjësisht të hyrjes në radhë për servisim të teleferikeve dhe është konsideruar si kritike një funksionim se ne konsiderojmë pamje jo e mirë, përderisa ne po e promovojmë Brezovicën që dikush shkon ta shohë atje dhe të shohë që atje me të vertetë bëhen vetëm improvizime nga operatorët privatë që ju ndihmojnë skitarëve që të ngjiten deri lartë dhe pastaj të skijojnë. Që është paraprë të bëhet fillimisht sigurimi i objekteve ekzistuese gjegjësisht i vazhdimit të veprimtarisë se objekteve ekzistuese që në fazat e hershme të kontratës mos të fukosohen në investime të mëdha dhe të lihen objektet ekzistuese apo teleferiket pa funksion por të vëhen ato në funksion dhe gradualisht pastaj të shkohen në faza të tjera të zhvillimit dhe natyrisht krahas kësaj edhe minimizimi i ndikimit negativ në mjedis.

Jemi tërësisht të vetëdijshëm dhe natyrisht që kuptojmë dhe nuk do të shkonim në kundërshtim me ligjin sidomos jo si komision ndërqeveritar anëtar i se cilit është edhe Ministri i Mjedisit, që në kuadër të projektit të Komisionit Evropian ka pasur kundërshtime gjegjësisht ka pasur komentet e veta të cilat nuk kanë shkuar me linjë me këtë projekt ëë atë kohë po tash që do të shiqojmë për se afërmë dhe, në lidhje me fazën referencën e Ligjit në fazën e planeve dhe programeve në fund nuk e kemi planin e zhvillimit të kësaj pjesë gjegjësisht ne kemi bërë thirrje për shprehje të ineteresit për ofrim të planeve për arsyeje se koncertiumet të cilat janë të profesionalizuara në zhvillimin e resorteve të tilla do të ju ofrojmë planet të cilat që ata i konsiderojnë në këtë hapësirë cilat janë ato me të mirat që të kenë ndikim maksimal në ekonomi, ndërsa ndikim të minimizuar në mjedis dhe në momentin kur të miren këto plane vlerësimi për këto plane do të jenë në konfort kritereve dhe ligjeve në Kosovë.

Afërdita Berisha-Shaqiri pyeti e si po e arsyetoni edhe Zonën A në Zonën Strikte edhe Zonën Strikte të Parkut Nacional ju po e ofroni dhe si po e arsyetoni ndërtimin në zonën A.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila ne nuk e kemi ofruar Zonën A për ndërtim kjo kemi të bëjmë me aktivitete të ndryshme përderisa në themi se e gjithë kjo fazë është për zhvillim atëherë parashihet që në kuadër të kësaj të kemi staza të skijimit nuk po flas për Zonën A po për projektin në tërësi, zhvillim të pjesës së hotelierit gjegjësisht shërbimeve, por edhe zhvillim të stazave për ecje dhe për aktivitete të tjera kreative të cilat ju domosdoshmërisht, ndërtim në kuadër të kësaj zone. Ne në përgjithësi zhvillimin e Brezovicës nuk e shohim vetëm për aktivitetet të skijimit, ajo parashihet që të jetë një resor malor për 12 muajt të vitit në mënyrë që edhe aktiviteti pranveror dhe aktiviteti i verës të jenë qofshin me ciklizëm, ecje, alpinizëm apo të ngjajshme po që të ketë mundësi të ofrimit të shërbimit turistik.

Liburn Aliu kur i keni ftu të shprehin interes për këtë projekt, për Zonën A thuhet:” terrenet janë në dispozicion për të gjitha nivelet e skijimit dhe zhvillime me destinime të ndryshme. Zona A jo e tërë zona është në kuadër të Zonës Strikte pra është një pjesë e Zonës A e cila është mbi 1800m me ndërtime jashtë Zonës Strikte perkatesisht zonën 3 kjo pjesë është plotësisht e mbuluar me pyje, nuk mundet me ndërtu staze skijimi pa pre pyeje. Thuhet ndikim minimal mjedisor në zonën, në zonën e parë e cila është strikte nuk lejohet as boronicat mi mbledh, nuk lejohet mu pre pyejet as për mirëmbajtjen e tyre. Në Zonën e dytë lejohet veprimtari e kufizuar por nuk lejohet ndërtimi mundë të lejohen aktivitete të kufizuara siq është blegtoaria, prerja e kontrolluar e

pyejeve etj. Ndërsa në Zonën e 3 lejohet ndërtimi me objekte të përkohshme, sipas Ligjit të Parkut Nacional dhe Ligjit të Natyrës. Kur jemi në fazën e projektit ideor kërkohet një vlersim paraprak mjedisor konform Ligjëve.

Kryetari Nait Hasani, potencoi në lidhje me teleferikun se kapaciteti teknik i teleferikeve është 10.000 skijatore për orë ndërsa kapaciteti total i hapësirës së skijimit është 50.000 skijatore në të njëjtën kohë. A i ka mbulu Kosova këto kapacitete që me zhvillu një plan tjetër?

Nijazi Idrizi, theksoi se projekti është në fazën ideore dhe kjo është logjike se duhet të respektohen Ligjet dhe planet hapësinore për zonat e mbrojtura.

Salih Morina, kërkoi që për pyetjet të cilat nuk ka arritë të ju përgjigjet ministrja të na i dërgoni me shkrim.

Azem Rexhaj udhëheqës i projektit, kemi një keqkuptim të vogël në lidhje me projektin dhe fazën në të cilën jemi, prezantimi i cili është bërë para investitorëve në lidhje me Zonën A, B, C dhe D, këtu janë prezantuar potencialet që ofron Brezovica dhe potencialet e Brezovicës janë marrë nga studimet. Mirëpo këto nuk janë kusht për investitorin dhe as nuk kërkohet dhe pikërisht vendimet e komitetit ndërmëtor dhe shqetësimet e juaja përputhen saktësisht, sepse në dokumentin zyrtarë që ju ka dhënë të gjitha kompanitë të interesuara thuhet qart se duhet të bëhet zhvillimi i Brezovicës ekzistuese fillimisht kjo lidhet me kapacitetin që ekzistojnë dhe investitorët e kanë mundësinë e tyre me prezantuar zhvillimin nëpër faza, që nënkupton nëse ata nuk e parashohin që nuk mund të jenë më shumë se 50.000 turistë në ditë ata nuk e prezantojnë fazën e dytë, dhe poashtu sa i përket Zonës Strikte në pikën 2 të konceptit të zhvillimit të projektit është thënë shumë qart se zona A1r dhe A4 që janë ato pjesë me një biodiversitet shumë më të zhvilluar pra këto janë zonë që edhe investitorëve është bërë me dije qysh në fillim. Rexhaj theksoi se në nuk jemi asnjë draft projekt propozues zyrtarë të aprovuar, të gjitha këto që janë ofruar për investimin për investitorët janë ofruar vetëm si mundësi që edhe ata ta shohin se Brezovica ofron mundësi dhe kapacitete sepse ne po të mos ju ofronim asgjë ata nuk vijnë dhe saktësisht këto përputhen me shqetësimet e deputetit Aliu që Zonat Strikte duhet të kenë një konsideratë të veçantë A1r, A11 dhe A4 janë zona që kanë një biodiversitet më të zhvilluar.

Liburn Aliu pyeti a janë të përfshirë ato në projekt? sepse Ligji ato duhet të përjashtoj nga projekti, sepse kjo Zonë që është Zonë Strikte nuk është pjesë e projektit sepse me Ligj nuk lejohet.

Azem Rexhaj në nuk jemi një projekt, dhe zonat nuk janë të aprovuara ende dhe kemi vetëm një draft, një draft të parkut dhe në fakt vetëm në Ligj janë të parapara kufinj të jashtëm mirëpo ndarja e zonave nuk është bërë ende.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila mori fjalën dhe theksoi se në kemi një dokument zyrtar që është dhënë kompanitë të cilat kanë shprehur interes gjegjësisht kanë kërkuar me shumë informacione, në kemi marrë zonat si në tërësi në kuadër të një pjesë siq e përmendi edhe ju zonës që ka hapësirë për zhvillim është një pjesë që edhe një zonë e lartë e ndjeshmërisë d.m.th është afër në pjesën A që është e specifikuar në kuadër të projektit janë informacione që ata kanë marrë nga MTI ku kanë shprehur interes që të aplikojnë pastaj për shprehje të interesit, d.m.th. është e ndarë pjesa që thuhet se është fushatë me ndjeshmëri të lartë mjedisore është e përcaktuar në kuadër të materialit që është dhënë.

Kryetari Nait Hasani kërkoi që të bëhet edhe një takim tjetër në lidhje me çështjet për cilësinë e derivateve naftës dhe Ministrja Mimoza Kusari-Lila u dakordua për këtë.

5. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani i njoftoi deputetët në lidhje me gatishmërinë e ZRRUM-it dhe shefit të sajë Z. Raif Prenen që ta ndihmojë Komisionin, për angazhimin e ekspertëve dhe veprimet e tjera të nevojshme për ta procedur këtë Projektligj. Për shkak se angazhimi i ekspertëve është i nevojshëm dhe se buxheti i Komisionit është i mangët, **Komisioni e pranoi këtë gatishmëri të ZRRUM-it dhe njiherit e formoi grupin punues që do ta përcjellë këtë Projektligj.**

Në lidhje me gjendjen e pyjeve, zhvillimet, dëmet, shkatërrimin, që është bërë nga viti 2012, dhe për një senzibilizim për një mbrojtje më të mirë të tyre si dhe në pritje të Projektligjit të ri për pyjet, kryetari propozoi që të mbahet një debat parlamentar në Kuvend në lidhje me këtë temë. **Komisioni u pajtua që të dërgohet kërkesë për debat në Kuvendin e Kosovës.**

Gjithashtu Kryetari propozoi, që për Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje, të organizohet një debat publik në ndërtesën e Kuvendit (ose jashtë sajë nëse gjendet mbështetje për këtë) ku në këtë debat do të ftohen të gjithë të interesuarit duke filluar nga minsitritë, komunat dhe të gjithë të tjerët të interesuar. Dhe kërkohet nga MMPH që të na sjellë ortofotot për ndërtimet pa leje. **Për këtë propozim u dakordua edhe komisioni.**

Mbledhja përfundoi në orën 12,20

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani